



P Z A P  
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.40/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Ramush Bardiqi - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 17.09.2025, merr këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHEȚ** e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.40/2025 e datës 15.09.2025, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

**A r s y e t i m**

Me datë 15.09.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se me datë 14 shtator 2025, në emisionin "Context", në ATV, kandidati i LVV-së, për kryetar të komunës së Mitrovicës së Jugut, Faton Peci, ka përdorur gjuhë tërësisht fyeze ndaj kandidatit të PDK-së për kryetar të kësaj komune, z. Arian Tahiri. Gjatë kohës që z. Tahiri po fliste në debat, z. Peci i drejtohej atij me fjalët: "EH MORE QEN ", e cila deklaratë është në kundërshtim me nenin 34, paragrafi 1, pika 11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Në ankesë theksohet se përdorimi i fjalës "qen" nga kandidati i LVV-së, Faton Peci, është një shprehje tërësisht fyeze dhe denigruese. Përdorimi i kësaj fjale, veçanërisht në një debat publik, ka për qëllim të ofendojë dhe të diskreditojë personalitetin e kundërshtarit politik. Kjo është një fyerje që përbën një sulm ndaj dinjitetit të individit dhe synon të nxisë përcëmim dhe urrejtje ndaj personit në fjalë. Fjalët e tillë janë të papranueshme në një debat politik dhe janë në kundërshtim me etikën dhe rregullat e fushatës zgjedhore, duke kontribuar në një

atmosferë të tillë që nxit urrejtje dhe polarizim, përkundër parimeve të respektit dhe etikës që duhet udhëheqin procesin zgjedhor.

Po ashtu në ankesë theksohet se pjesa e emisionit ku z. Peci i drejtohet z. Tahiri me fjalët "Eh more qen" është shpërndarë gjërësisht në rrjetet sociale, duke arritur një shikueshmëri të konsiderueshme, e cila përhapje ka shkaktuar një reagim të fortë nga opinioni publik, duke e bërë këtë incident të njohur gjërësisht dhe duke përfotuar dëmtimin e imazhit të kandidatit Arian Tahiri. Fyerja e përdorur ka krijuar një atmosferë të tensionuar dhe ka nxitur polemika të shumta, duke pasur ndikim negativ jo vetëm në procesin zgjedhor, por edhe në marrëdhëniet shoqërore dhe politike në komunitet.

Në këtë kontekst, deklarata fyeze e Faton Pecit është një shkelje e rëndë jo vetëm e etikës politike, por gjithashtu një tentativë për të ndotur dhe minuar cilësinë e debatit publik dhe për të përcmuar kandidatin Arian Tahiri.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), theksohet se nga shqyrtimi i video incizimit, ndonëse i prerë qëllimisht ashtu që të mos dëgjohet e tërë fjalia, qartë dëgjohet se z. Peci ka përdorur fjalën "çun", një shprehje e zakonshme e zhargonit popullor që nënkupton "djale" ose "i ri". Se bëhet fjalë për fjalën "çun" dëshmon edhe fakti se nuk pati reagim as nga ana e moderatorit e as nga ana e kandidatit të PDK-së. Kjo fjalë nuk ka asnjë konotacion fyes dhe nuk përbën veprim që parashihet në ndalesat e nenit 34, paragrafit 1, pikës 11, të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Pretendimi i palës ankuese se është përdorur fjalë "qen" bie ndesh me provat faktike. Nuk ekziston asnjë dëshmi e besueshme që ta mbështesë një pretendim të tillë. Përkundrazi, provat në dispozicion dëshmojnë qartë përdorimin e fjalës "çun", e cila nuk përbën ofendim. Dëshmitarë se kemi të bëjmë me fjalën "çun" e jo "qen" është, përveç ekipit të emisionit, edhe kandidati për asamble nga radhët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, Enis Osmani, i pranishëm në vendin ku po mbahej debati.

Ligi për Zgjedhjet dhe rregulloret e KQZ-së, ndalojnë përdorimin e gjuhës fyeze, shifëse ose nxitëse të urrejtjes gjatë fushatës. Megjithatë, në këtë rast nuk jemi përballë një gjuhe të tillë. Fjala e përdorur nuk ka karakter fyes, nuk cenon dinjitetin e askujt dhe nuk nxit urrejtje politike. Prandaj, nuk ekziston bazë ligjore për të konstatuar shkelje. Interpretimet e pasakta ose të qëllimshme të deklaratave nuk mund të shërbejnë si bazë për ndërmarrjen e masave ndëshkuese, theksohet në përgjigjen në ankesë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

- *Ankesa është e pabazuar.*

Paneli pas shkimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoi se pretendimet e subjektit politik - PDK se kandidati për kryetar të Komunës së Mitrovicës së Jugut, nga subjekti politik LVV - Faton Peci, ka kryer veprimet e pretenduara në ankesë, ku në emisionin "Context", në kanalin televiziv ATV, gjatë debatit publik ka përdor fjalë fyeze si "Eh more qen", ndaj Arian Tahiri, kandidat për kryetar të komunës në Mitrovicën e Jugut, nga radhët e subjektit politik PDK, nuk mund të vërtetohet në asnjë mënyrë. Kjo pasi që pas

vlerësimit të materialit procedural dhe të gjitha shkresave të lëndës, Paneli vlerësoi se nuk ka mundur në asnjë mënyrë të deshifrohet shprehja e pretenduar nga ana e palës ankuese, e të cilën e ka përdorur gjatë debatit kandidati në fjalë, andaj në mungesë të këtij vërtetimi është vlerësuar se në këtë rast nuk ka pasur shprehje fyese ose denigruese nga ana e kandidatit në fjalë.

Materiali i paraqitur nuk përbën elemente të mjaftueshme provuese për të mbështetur pretendimet e paraqitura, prandaj nuk qëndron arsyё pёr ta konsideruar ankesën si të bazuar, e rrjedhimisht pёr të konstatuar se ekziston përdorimi i shprehjeve fyese apo denigruese të parapara sipas dispozitave ligjore të Ligjit pёr Zgjedhjet. Në mungesë të provave të qarta, të besueshme dhe të qëndrueshme, Paneli arrin në përfundim se pretendimet e parashtuesit nuk gjejnë mbështetje faktike apo juridike dhe rrjedhimisht, ankesa refuzohet si e pabazuar.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “*vendosja pёr ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, pёr faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të nenit 34, par. I, pika 11 të Ligjit pёr Zgjedhjet e Përgjithshme, e as të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, dhe si të tilla të njëjtat i refuzoi si të pabazuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, nenin 118 par. 1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor pёr Ankesa dhe Parashtresa

Anr.40/2025 më datë 17.09.2025



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.